



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**  
***Komisioni për Integrimin Europian***

*Dokument parlamentar*

**PROCESVERBAL**

Datë 12.05.2015, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Majlinda Bregu – kryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë””.
2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, si Administrator i Fondeve Grant të siguruara nga qeveri të vendeve të ndryshme nën Fondin e Veçantë të Aksionarëve të BERZH-it, për *by-pass*-et rrugore të Fierit dhe Vlorës, asistencë teknike për mbështetjen e zbatimit të projektit në Shqipëri”.
3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për investimin nga llogaria EU/IPA e *by-pass*-it Vlorë, për *by-pass*-in e Vlorës”.
4. Të tjera.

**Marrin pjesë:**

Majlinda Bregu, Esmeralda Shkja, Arben Imami, Taulant Balla, Bujar Derveni, Sadri Abazi, Kejdi Mehmetaj dhe Gerti Bogdani.

**Mungojnë:**

Edi Paloka, Gramoz Ruçi dhe Ilir Xhakolli.

**Të ftuar:**

Lindita Nikolla – ministre e Arsimit dhe Sportit

Nora Malaj – zëvendësministre e Arsimit dhe Sportit

Adriana Berberi – drejtore kabineti në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit

Plarent Ndreca – sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit

Ermal Elezi – drejtor i Drejtorisë së Integritimit dhe Projekteve

Pëllumb Karameta – këshilltar

Agim Leka - këshilltar

Zamira Gjini – drejtore e Arsimit Parauniversitar

Gerti Janaqi - drejtor i IZHA-së

Gjergji Hamiti - këshilltar për medien

Elda Sotiri – përfaqësuese e MIE-së

Ylli Manjani – zëvendësministër i Ministrisë së Transportit dhe Inovacionit

Mimoza Loli – përfaqësuese nga Ministria e Financave

Elona Mishovica – përfaqësuese nga Ministria e Financave

## HAPET MBLEDHJA

**Majlinda Bregu** – Përshëndetje! Hapim mbledhjen e komisionit.

Faleminderit që keni ardhur!

Ju falënderoj dhe për nervin e qetë me të cilin pritet të mblidhet ky komision në kohë fushate.

Në rendin e ditës së sotme, përveç procesverbalit të mbledhjes së komisionit të kaluar, për të cilin nuk besoj se ka ndonjëri ndonjë vërejtje, apo koment, pra e quajmë të miratuar kemi projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë””.

Më pas kemi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, si Administrator i Fondeve Grant të siguruara nga qeveri të vendeve të ndryshme nën Fondin e Veçantë të Aksionarëve të BERZH-it, për *by-pass*-et rrugore të Fierit dhe Vlorës, asistencë teknike për mbështetjen e zbatimit të projektit në Shqipëri”.

Kemi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për investimin nga llogaria EU/IPA e *by-pass*-it Vlorë, për *by-pass*-in e Vlorës” për të cilat pas ministres së Arsimit do të mbërrijë besoj zëvendësministri i Transportit. Kemi dhe çështje të tjera.

Zonja Ministre, duam një prezantim të projektligjit i cili dje është diskutuar në komisionin përgjegjës, në Komisionin e Medias dhe të Arsimit.

Ndërkohë, ne jemi të detyruar të shohim përputhjen apo pikëprerjet me legjislacionin e BE-së.

**Lindita Nikolla** - Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,

Projektligji i paraqitur për miratim në Kuvendin e Shqipërisë mundëson ndryshimet e cilësisë së domosdoshme në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”. Ky është një projektligj që vjen për të

adresuar shumë nga problematikat që sot ka sistemi ynë parauniversitar. Ky projektligj është në përputhje me programin politik të Këshillit të Ministrave. Sigurisht për hartimin e tij është marrë parasysh i tërë korpusi ligjor shqiptar në fuqi i lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë, apo dhe të tërthortë me arsimin dhe specifikisht me zhvillimin e arsimit parauniversitar.

Projektligji i paraqitur është një hap tjetër drejt përsheptimit të integritimit të arsimit parauniversitar në sistemin arsimor evropian, konsolidimit të reformave të rëndësishme të ndërmarra së fundmi dhe që kanë si fokus kryesor cilësinë në sistemin tonë arsimor, si dhe krijimit të hapësirave për reforma të tjera në përmirësimin e rritjes së kësaj cilësie. Për hartimin e këtij projektligji sigurisht që jemi mbështetur në dokumentet e BE-së për çështje të arsimit, konventa e karta ndërkombëtare që kanë të bëjnë me arsimimin e nxënësve, si dhe ligje analoge të viteve të fundit të shumë shteteve të zhvilluara apo të rajonit. Është hartuar me pjesëmarrjen e ekspertëve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, të institucioneve të saj të varësisë, të drejtorive arsimore rajonale, zyra arsimore, si dhe në bashkëpunim me ekspertë të fushës së edukimit, ekspertë ligjorë, si dhe grupet e interesit.

Ju bëj me dije që është marrë dhe mendimi i Ministrisë së Integritimit dhe çështjet e propozuara në ligj nuk janë çështje të përafrimit. Arsimi është kryesisht fushë kompetence e vetë vendeve anëtare. Unë po kaloj të gjitha ndryshimet që propozohen në këtë projektligj, ndryshime që propozohen për të reflektuar prioritetet aktuale të qeverisë dhe harmonizimit të koncepteve dhe përkufizimeve si të kornizës kurrikulare, kompetencave themelore, qëllimit të arsimit parauniversitar, si dhe strukturën e arsimit bazë.

Në projektligj janë propozuar ndryshime në nenin 2, në pikat 8, 10, 12, dhe 19 të cilat propozohen, ndryshohen me qëllim hartimin dhe zbatimin e kurrikulës së re. Besoj që opinionin publik dhe ju, të nderuar zonja, dhe zotërinj deputetë, jeni në dijeni që sistemi ynë arsimor parauniversitar është përfshirë në një reformë të re kurrikulare e bazuar në kompetenca dhe që është edhe trendi i gjithë sistemeve arsimore parauniversitare të Europës, por edhe të vendeve të zhvilluara. Sigurisht që janë ndryshime që janë bërë të unifikuara edhe me sistemin arsimor të Kosovës, por dhe të vendeve të tjera të rajonit. Po vijoj me nenet përkatës ku propozohen ndryshimet.

Pika 8 që ka të bëjë me përkufizimin e kurrikulës. Sigurisht futja e sistemit tonë arsimor nën kurrikulën e re kërkonte rikonceptim të nenit 13 lidhur dhe me kompetencat themelore për nxënësit. Këto për arsye se sot kompetencat konsiderohen kapitali më i rëndësishëm për të gjeneruar ide të reja dhe për të arritur mirëqenie vetjake dhe shoqërore. Shkolla duhet t'i ndihmojë të rinj dhe të reja që krahas kompetencave të përgjithshme për jetë dhe punë të zhvillojnë dhe kompetenca të reja që i ndihmojnë të përshtaten në botën e sotme të zhvillimit të teknologjisë dhe informacionit.

Ndryshimi tjetër. Neni 3 ka të bëjë me përcaktimin e qëllimit të sistemit arsimor parauniversitar që lidhet me rikonceptimin e qëllimit të sistemit parauniversitar për arsye se sistemi arsimor parauniversitar ka për qëllim krijimin e kushteve dhe mundësive që nxënësit të ndërtojnë dhe të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe kompetenca që kërkon shoqëria demokratike, të zhvillohen në mënyrë të pavarur, të gjithanshme. Të kontribuojnë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake. Dhe të shoqërisë shqiptare dhe të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

Ndryshimi tjetër ka të bëjë me kompetencat themelore. Më lejoni t'ju bëj me dije që ndryshimi i nenit 13 mbi kompetencat themelore, duke iu referuar dhe rekomandimit të Parlamentit Europian dhe Këshillit të Europës, datë 18.12.2006 mbi kompetencat themelore, rekomandimi nuk është detyrues për vendet anëtare. Rekomandohet që në vendet evropiane arsimit parauniversitar të bazohet në qasjen me kompetenca dhe pikërisht në këtë kemi bërë. Jemi larguar nga qasja e vjetër që orientohet drejt objektivave duke futur tërë sistemin tonë arsimor në këtë qasje të re evropiane që bazohet në kompetenca.

Numri i kompetencave dhe emërtimi i tyre ndryshojnë në bazë të nevojave dhe prioriteteve kombëtare të secilit shtet. Për shembull korniza kurrikulare e Çekisë përmban 6 kompetenca, ajo e Anglisë 6, Skocia 3, Franca dhe Finlanda kanë 7, Kroacia 8, ndërsa Hungaria 9 kompetenca. Në vendin tonë kurrikula e reformuar e sistemit parauniversitar bazohet në këtë qasje dhe organizohet sipas një strukture që mbështet zhvillimin e tyre.

Pra, kompetencat sipas fushave të të nxënësit në shkallë kurrikule, rezultatet e të nxënësit dhe kompetencë për fushë. Ajo zhvillon kompetencat kyçe bazuar në ato evropiane dhe strukturohet sipas rezultateve të të nxënësit për kompetenca dhe fusha të të nxënësit. Kompetencat janë 7 dhe janë të unifikuara me sistemin e orientuar në bazë të

kompetencave të Kosovës, kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit, kompetenca e të menduarit, e të mësuarit për të nxënë, për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin, kompetenca personale, kompetenca qytetare dhe kompetenca dixhitale.

Ndryshimi 4, pika 2 e nenit 22 ka të bëjë me ndryshimin e strukturës të sistemit tonë arsimor parauniversitar. Sipas ligjit aktual struktura e sistemit arsimor parauniversitar pas vitit 2015 do të ishte 6 plus 3 plus 3. Pra, jemi në sistemin 5 plus 4 plus 3. Ligji aktual supozonte që në këto 7 orë ne duhet të kalonim në strukturën 6 plus 3 plus 3. Propozimi ynë është që të ruhet struktura 5 plus 4 plus 3 pas një diagnostikimi të plotë dhe të thellë që ne i kemi bërë të gjithë sistemit dhe posaçërisht cilësisë së burimeve njerëzore, cilësisë së mësuesve, e koordinuar kjo dhe me cilësinë, me kurrikulat e përgatitjes së mësuesve në universitete. Pra, në fakultetet e edukimit. Sipas të gjithë ekspertizës së bërë kësaj fushe rezulton se mësuesit nuk janë të përgatitur shkencërisht dhe profesionalisht të përballojnë procesin e mësimdhënies, lëndët në të gjitha fushat në klasën e gjashtë. Sigurisht ndryshimi i strukturës bëhet gjithashtu për të qenë në përputhje edhe me strukturën e arsimit në Kosovë pasi ne jemi në rrugën e unifikimit të sistemeve arsimore Shqipëri-Kosovë.

Gjithashtu, më lejoni t'ju bëj me dije që ka shumë vende si Çekia, Franca, vende të tjera që, gjithashtu, kanë strukturën arsimore 5 plus 4 plus 3, ashtu sikurse ka strukturë edhe 7 plus 4 plus 2. Pra, nuk është një formulë e përcaktuar, e prerë për të siguruar që të gjitha vendet që mund të ecin në këto vite shkollimi të përcaktuara sipas strukturës.

Në nenin 45 pika 2 lidhet me përcaktimin e kurrikulës bërthamë duke pasur një shmangie nga koncepti i standardit dhe kurrikulës bërthamë. Sigurisht standardi përcakton se çfarë duhet të dijë dhe të jetë në gjendje të bëjë nxënësi në fund të një periudhe të caktuar shkollimi e cila mund të jetë një, dy, apo një cikli shkollimi. Në sisteme të ndryshme gjenden të gjitha këto përvoja. Ne jemi në mes të një reforme dhe sigurisht duke realizuar një proces pilotimi që do të ndihmojë në nxjerrjen në fakt të shumë problemeve që lidhen si me hartimin e kurrikulës, me objektivet e saj, por sigurisht dhe me aftësinë e pushtetit vendor për ndërhyrjet dhe për të gjitha kompetencat që ka në sistemin tonë arsimor parauniversitar, sigurisht shkollës dhe mësuesve për të marrë përsipër detyra partneriteti në bërjen dhe zbatimin e kurrikulës. Ndaj në këto kushte mendojmë që të shmangim termin standard nga ligji “Për arsimin” dhe kur themi

këtë sigurisht nuk nënkuptohet heqja dorë nga përpjekjet për të garantuar kushtet që mundësojnë realizimin e tij, kushte që në literaturë arsimore quhen standardet e shkollës. Kur gjujkojmë që këto kushte janë në shkallë të tillë që garantojnë realizimin e një objekti atëherë mund të përdoret dhe termi standard.

Propozohet të përdoret termi kurrikul bërthamë, e cila në konceptimin aktual lidhet me atë që duhet të dijë dhe të jetë i aftë të bëjë nxënësi në një shkallë kurrikule. Pra, nga 2 deri në 3 vjet. Periudha të tilla janë më të menaxhueshme. Procesi i pilotimit ka si objektiv edhe vetë përmbajtjen e kurrikulës bërthamë. Ndaj që ajo të jetë sa më pranë termit standard, të shprehë thelbin e politikës arsimore në nivel kombëtar dhe detyrimit tonë për të garantuar cilësi shërbimi të barabartë në këtë vend, ajo duhet të vijojë me procesin e pilotimit dhe të matjes së gjithë rezultateve.

Në nenin 47 pikat 1, 2, dhe 3 kanë të bëjnë me tekstet. Besoj se është një moment që është debatuar dhe ka tërhequr të gjithë vëmendjen e opinionit publik.

Më lejoni të them që në krye se nuk bëhet fjalë as për përmirësim apo për përmbysje të alartekstit, por për një zhvendosje nga alarteksti, si një politikë transitore në fushën e teksteve shkollore të reja, dhe në kushtet e një mosbesimi të madh, një problematikë e madhe e vërejtur në këto vite me cilësinë e teksteve shkollore dhe me alternativat e pakufizuara. Më lejoni të shtjelloj të gjitha analizën e realizuar për propozimin e kësaj politike të re transitore dhe ndryshimin përkatës ligjor. Nuk janë nga relacioni këto që do të them, por janë argumente, analiza të tjera.

Alarteksti ishte një përpjekje për të përfitur cilësinë e teksteve mes konkurrencës së lirë. Sigurisht edhe pse konkurrenca nuk është shkopi magjik pa dyshim është më e mira. I ofruar nga ky këndvështrim, alarteksti i qëndroi bukur idealit apo aspiratës për tekstet cilësore në arsimin tonë në tranzicion. Por ndërkaq të dhënat tregojnë se politikat për përjetësimin e kësaj asperate, pra tekstet cilësore për nxënësin, nuk arriti ta jetësojë atë. Sigurisht ekonomia e tregut mund të funksionojë efektivisht vetëm me një mjedis ekonomik shoqëror ku pranohen dhe zbatohen rregulla që përcaktojnë dhe mbikëqyrin sjelljen në treg dhe e bëjnë konkurrencën jo vetëm të lirë, por edhe të ndershme.

Më lejoni t'ju bëj me dije pa u zgjatur në të gjithë analizën vetëm dy momente shumë të rëndësishme. Shqipëria ka nevojë ose sistemi ynë arsimor parauniversitar ka

nevojë përreth 171 tekste. Ndërkohë që numri i alternativave kap shifrën e 1130 tekste shkollore duke kapur dhe për një lëndë të caktuar edhe mbi 10 alternativa. Sigurisht mjaft tekste kanë rezultuar me cilësi jo thjesht cilësi jo të mirë, metodologjia e përdorur, por dhe me gabime shkencore dhe besoj se opinioni publik, media po ashtu është njohur. Më lejoni t'ju bëj me dije se vetëm për hartimin e një teksti duhet grupi i autorëve, duhet të jetë përcaktuar recensenti, redaktori dhe shumë elementë të tjerë që janë standarde të botimit të një teksti. Dhe besoj që për Shqipërinë tonë është e pamundur që të gjesh gjithë këto burime njerëzore në sasinë e kufizuar të teksteve. Pra, për 171 tekste mendoni tani gjithë këtë armatë të madhe njerëzish që do të duhen për të përballuar 1130 tekste në kushtet kur si universitetet si botuesit, edhe shtëpitë botuese nuk i kanë paraprirë këtij procesi me një proces tjetër kualifikimi, trajnimesh e kështu me radhë.

Pa folur pastaj që kur ka deformime në procesin e përzgjedhjes së teksteve për arsye nga më të ndryshmet, qoftë dhe ndërhyrjet e politikës, ndërhyrjeve klienteliste, duke mundësuar që mësuesit mos të zgjedhin tekstin që ata dëshironin, por tekste që vinin nga ky imponim. Nga ana tjetër ju bëj me dije që mësuesit nuk janë përgatitur apo trajnuar për të bërë një përzgjedhje cilësore dhe profesionale të teksteve, ashtu sikurse nuk kanë asnjë formim të tillë që vjen vlerësimi të tekstit më të mirë që vjen nga formimi i tyre universitar.

Në vitin 2014, biem dakord dhe ky është një konstatim që e kanë shprehur edhe botuesit, ne realizuam një proces përzgjedhës duke u kujdesur maksimalisht për miradministrimin e përzgjedhjes. Pra, që realisht do të zgjidhte mësuesi. Përpara se të shkonim te ky proces përzgjedhës pyetëm të gjithë mësuesit në sistem për të evidentuar të gjitha problematikat që ato kishin hasur gjatë procesit të përdorimit të teksteve të caktuara dhe të gjithë problematikat që vinin nga mësuesit jua vumë në dispozicion botuesve. Probleme që ishin shfaqur apo nxjerrë nga institucione të rëndësishme si Avokati i Popullit, Shoqëria Civile, por edhe nga media e shkruar dhe vizive dhe arritën që vetë botuesit në vitin shkollor, në këtë vit që jemi, të hiqnin nga botimi 130 tekste. Ndërkohë që mësuesit shpreheshin se 429 tituj të teksteve shkollore të hiqeshin nga qarkullimi për shkak të gabimeve shkencore të evidentuara edukative dhe sigurisht për shkak të zgjedhjes së tyre nëpërmjet ndërhyrjeve.



Në vitin që ne flasim pothuajse 1 muaj më parë kemi realizuar sërish një proces vlerësimi të teksteve që ishin në sistem, që janë në sistem nga të gjithë mësuesit e Shqipërisë. Më lejoni t'ju bëj me dije se 156 tekste nga 627 tekste alternativë vetëm 156 tekste janë votuar nga mbi 10% e masës së mësuesve. Pra, 470 tekste afërsisht 75% e teksteve që sot janë në sistem vlerësohen nga më pak se 10% e masës së mësuesve. Pra, vijojnë alternativat që mësuesi t'i përzgjedhë në masën 1%, 2% dhe 3%. Pra, janë vetëm 153 tekste që botohen nga mbi 10% e masës së mësuesve që janë pyetur për cilësinë e tekstit shkollor. Sigurisht janë dokumente që ne i kemi bërë publike, janë në dispozicion të botuesve. I kemi bërë publike për botuesit dhe dy distributorë që janë. Dhe sigurisht edhe për opinionin publik. Ato flasin vetë që praktikisht mësuesit në masë të madhe, në masën e mbi 60 apo 70%, shkojnë drejt një teksti unik mes teksteve që në këto 8 vjet janë cilësuar si tekste më pranë objektivave dhe qëllimeve të arsimit parauniversitar.

Unë mund të vijoj më pas me pyetjet tuaja për secilën. Janë shumë tregues që flasin për nevojat e reformës të plotë dhe të thellë të teksteve shkollore.

**Majlinda Bregu** – Mund t'u lëmë vend pyetjeve të deputetëve më mirë sesa të flisni ju. Besoj se do të ngacmoheni më shumë nga pyetjet.

**Lindita Nikolla** – Të vijoj se janë dhe dy ndryshime të tjera. Është pjesa e altertekstit.

**Majlinda Bregu** –Ndërkohë mund të na thoni dhe dy ndryshimet e fundit pa u zgjatur shumë, sepse ndërkohë ka mbërritur dhe zëvendësministri.

Gjithashtu t'u lëmë kohë më shumë deputetëve të shprehen, sepse relacionin e kanë lexuar të gjithë.

**Lindita Nikolla** –Dakord. Vijojmë me pyetjet.

**Majlinda Bregu** – Mbaro me prezantimin e dy ndryshimeve të fundit dhe pastaj vijojmë me pyetjet.

**Lindita Nikolla** – Ndryshimi tjetër është bërë pikën 1 të nenit 53, që ka të bëjë me medaljen e artë. Sigurisht nxënësve të shkëlqyer në vite pas përfundimit të arsimit të mesëm u jepet medalja e artë. Është propozuar nga Kryeministri me propozimin e ministrit për shkak të një shmangieje apo të një situatë të vështirë që ne kemi hasur në këto vite, pasi medalja e artë nuk përfshihet në dekoratat, titujt dhe medaljet e dhëna nga Presidenti i Republikës, sipas ligjit nr.112 të vitit 2013 “Për dekorata, titujt e nderit,

medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”. Ky ligj ka dalë një vit më vonë nga ligji nr.69/2012 dhe shfuqizon çdo akt ligjor apo nënligjor të dalë më parë, përfshirë dhe parashikimin e nenit 53 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.

Ndaj mbështetur në ligjin nr.112/2013 përcaktohet se autoriteti përgjegjës për dhënien e medaljeve sipas llojit të tyre, është Kuvendi, Kryeministri, ministri. Gjykuar për sa më sipër, propozojmë formulimin e nenit 53 të ligjit nr. 69/2012, që nxënësve të shkëlqyer në vite, pas përfundimit të arsimit të mesëm të lartë, t’u jepet medalja e artë nga Kryeministri, me propozimin e ministrit.

Ndryshimi i fundit, ndryshimi i tetë, neni 60, pika 1, ka të bëjë me emërimin e mësuesit. Në institucionin arsimor publik, për një vend të lirë pune mësuesi emërohet nga drejtori i institucionit arsimor me konkurrim të hapur. Procedurat e konkurrimit dhe vlerësimi përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Ky është propozimi që bëhet nga Ministria e Arsimit. Ne kemi debatuar edhe me fondacionin Soros, kemi debatuar sigurisht edhe me sindikatat, dhe jemi të gatshëm me atë që ata kërkojnë, që këtu të shtohen vetëm termat: procedurat e konkurrimit dhe komisioni i vlerësimit të përcaktohet me udhëzim ministri.

Faleminderit!

**Majlinda Bregu** – Zonja Ministre, faleminderit për prezantimin e detajshëm të ndryshimeve që propozohen në këtë projektligj!

Atëherë, do të fillojmë me pyetjet dhe komentet nga deputetët. Unë kam dy pyetje, si fillim. Më pas do t’ua jap mundësinë kolegëve.

Në momentin kur keni ardhur në qeveri, keni deklaruar – në mos ju, Kryeministri, një nga të dy, në mos qofsha e gabuar – se keni gjetur 177 mijë mësues pa arsimin përkatës. Mbas këtyre dy viteve, nga kjo armatë e madhe mësuesish, 177 mijë, të cilët në fakt na shqetësojnë të gjithëve, sepse kanë rritur, mësuar dhe edukuar fëmijët tanë, dhe duke pasur parasysh se çdo gjë të bërë keq, dhe që kishte qenë shumë keq, ju do ta bënit shumë mirë, sa keni arritur të sillni cilësi në mësimdhënie me mësuesit e rinj që ju keni përzgjedhur, përfshirë këtu edhe mësuesit apo drejtorët e shkollave, të cilët, në fakt, jo për përgjegjësinë tuaj personale – nuk besoj as për përgjegjësinë personale të Kryeministrit, por fati i keq që qëlloi në kohën e qeverisjes suaj – kanë sjellë

problematika, të cilat kanë qenë shumë të mëdha dhe tronditëse për opinionin publik; ju kujtoj rastin e mësueses me dhunën e ushtruar në klasë ndaj nxënësve apo, akoma më keq, drejtoreshën e arsimit në Lushnjë, pra, nga kjo armatë sa janë ende pa arsim përkatës?

Pyetja e dytë. Edhe në këtë projektligj synimet janë shumë të mira, sepse ligji bazë, në fakt, është shumë i mirë, flisni për pjesën e pajisjes dhe aftësimin të fëmijëve me kompetenca digjitale. Me thënë të drejtën, neve që kemi fëmijë në moshën e shkollës, nuk na duket se është ndonjë sfidë e madhe, se na e kalojnë edhe neve për kompetenca dixhitale, por meqenëse ju keni propozuar të krijoni dhe do të sillnit një platformë dixhitalizimi të sistemit arsimor, ku jemi sot me këtë platformën e dixhitalizimit të sistemit arsimor?

Edhe një pyetje të tretë, të cilën e kam me merak, sepse e shoh si mungesë në shkolla: përveç pjesës së kurrikulës, me të cilën nxënësit duhet të pajisen, a mendoni se do të ishte me vend – e ndoshta jemi edhe vonë – për t’u kushtuar vëmendje atyre elementeve, të cilat janë prezente sot në jetën e përditshme të fëmijëve, siç është bullying në shkolla? Nëse Ministria e Arsimit ka ndonjë strategji, që përveç pjesës së mësimdhënies t’i trajtojë e t’i aftësojë mësuesit, në bashkëpunim, pse jo, edhe me psikologun, punonjës social nëpër shkolla? Pra, unë nuk di që të kemi ndonjë strategji gjithëpërfshirëse, ku këto probleme të jenë ato që përfshijnë jo vetëm fëmijët e arsimit parashkollor për çështjet e dhunës apo për çështjet e keqtrajtimit, të mosrespektimit nëpër shkolla, të cilat sigurisht nisin nga mësuesit, jo vetëm, duhet të gjejnë vend në strategjinë e arsimit parauniversitar.

Këto ishin pyetjet e mia. Do të ishte më kollaj për ju, besoj, në rast se do të mbledhni pyetje edhe nga kolegët, dhe pastaj t’u përgjigjesht me radhë.

Po, Bujar!

**Bujar Derveni** – Faleminderit, zonja kryetare!

E dëgjova me vëmendje zonjën ministre në lidhje me shpjegimet që dha për ndryshimet në këtë ligjin parauniversitar.

Te neni 6, te ndryshimet për tekstet, e dëgjova shpjegimin, unë vetë jam i qartë, por këtu tekstet për nxënësit janë unike për çdo lëndë ose fushë të të nxëni. E thënë më shkoqur edhe për opinionin qytetar, një lëndë, lënda e historisë, do të jetë e njëjtë në të gjitha shkollat dhe në të gjithë Shqipërinë?

Së dyti, te neni 8, në lidhje me emërimet: i jepet kompetencë drejtorit të institucionit arsimor, që janë drejtoritë arsimore. Drejtori i shkollës do të ketë emërimin. Pra, ku qëndron risia në krahasim me atë praktikë që ishte deri tani, që siç e thatë edhe ju, siç thuhet dhe në relacion, nuk arriti të jetë efektive?

*(Diskutime pa mikrofon)*

Dhe vazhdon akoma situata, që të kemi...

*(Diskutime pa mikrofon)*

...të kemi mësues që japin lëndë jashtë profilit, që s'kanë lidhje me atë lëndë, dhe ka akoma vende vakante që nuk zëvendësohen, megjithëse ka kërkesa dhe mjaft njerëz të gatshëm për t'u punësuar.

**Majlinda Bregu** – Tjetër pyetje? Zoti Bogdani?

**Gerti Bogdani** – Kam përshtypjen se çështja e emërimit të mësuesve i bie të jetë një çështje me interes për të gjitha palët. Do të theksoja atë që thatë ju, zonja kryetare e komisionit: këto ndryshime, a i parandalojnë rastet, si rasti i Lushnjës, i zonjës Tabaku në Lushnjë? Ju thatë se u ndryshuan dy terma: procedurat e konkurrimit dhe vlerësimet. Procedurat e konkurrimit, do të jenë konkurrenca fiktive, si ato që u bënë për drejtoritë arsimore, pra kush punon më mirë në fushatë bëhet drejtoreshë, apo do të jetë në bazë të cilësive dhe aftësive? E para kjo.

E dyta, në lidhje me tekstet, jam shumë dakord me paraqitjen që bëri Ministria dhe me analizën që bëri për tekstet e ndryshme. Një pyetje kam: ndryshimet në ligj, a mendoni se do të sjellin tekste më të mira dhe nuk do të kemi tekste si ato që dolën në publik vjet, ku nxënësi mësoi të pinte shkumës, që t'i hipte temperatura, për të mos shkuar në shkollë? Apo ku motra mësoi se si të vidhte biletën e trenit për vëllanë, a ku di unë, disa budallallëqe të tjera të matematikës dhe të fizikës?

E treta, për sa i përket medaljes së artë, meqë u diskutua edhe përpara se të fillonte mbledhja

*(Diskutime pa mikrofon)*

Edhe në gjimnaze e në universitet. Përveç kësaj, përveç ndryshimeve në procedurën e dhënies së medaljes së artë, a ndryshojnë kriteret?

Faleminderit!

**Majlinda Bregu** – Vetëm faktin se do ta jepte Kryeministri medaljen, nuk e kape dot, por, mund të marrësh një medalje tjetër.

Ka pyetje të tjera?

*(Diskutime pa mikrofon)*

A ka pyetje të tjera? Nuk ka pyetje të tjera.

Atëherë, zonja Ministre!

**Lindita Nikolla** – Po, faleminderit për pyetjet!

**Majlinda Bregu** – Do t’ju lutesha direkt në përgjigje, që të mos...

**Lindita Nikolla** – Qartë, qartë!

Zonja kryetare!

Shqipëria ka 38 mijë mësues në total dhe nuk mund të ketë 177 mijë mësues pa arsim përkatës.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Atëherë, e vërteta është kjo, në fakt. Nuk është folur për 177 mijë mësues pa arsim përkatës, por është folur për 4 mijë mësues pa arsim përkatës. Ndikimi që kanë pasur këta 4 mijë mësues pa arsim përkatës në 177 mijë nxënës.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Jo, jo, e kam thënë unë këtë.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Jo, jo, qartësohu, zonja kryetare, sepse është një lapsus juaji.

**Majlinda Bregu** – Zonja Ministre!

Këtë pjesën e shifrave e keni shumë të bukur, sepse, ngaqë i thoni dhe nuk i dini, pas kësaj arrini dhe nuk i përpunoni dot.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Lindita Nikolla** – Tani, unë kam studiuar matematikë dhe s’mund të më akuzosh.

**Majlinda Bregu** – Edhe unë, pikërisht ngaqë lexova deklaratën jua bëra pyetjen.

**Lindita Nikolla** – Jo, jo, lexoje!

**Majlinda Bregu** – Kështu që, duhej ta kishit shumë të qartë se përse po ju pyes.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Lindita Nikolla** – Në muajt tetor nëntor Ministria e Arsimit ka realizuar një inspektim të plotë të burimeve njerëzore në çdo shkollë të Shqipërisë. Pa dyshim është një raportim i saktë, emër për emër, në çdo shkollë të Shqipërisë, për situatën e burimeve njerëzore. Lejomëni, e nderuara zonja kryetare, të nderuar zonja e zotërinj deputetë, t’ju them se nuk është çështja për të thënë se sa keq u gjet sistemi apo se çfarë po bëjmë ne. Pra, janë të gjitha arsyet e mendjes e të zemrës për të mundësuar, ose më saktë për të pamundësuar që një në katër nxënës jo të një klase, pra që në shumatore janë 177 mijë nxënës, të mos kenë fatin e keq që, në një prej orëve të mësimit, të marrin mësim nga mësues pa arsim përkatës apo jashtë profilit.

Kjo është një e vërtetë. Ju mund ta verifikoni në çfarëdo lloj mënyre që të doni, pa qenë nevoja për ta bërë mediatike. Kemi raportet e çdo shkolle, sepse është bërë inspektim sy më sy me të gjitha dosjet që çdo shkollë në Shqipëri ka në dispozicion, që lidhet me burimet njerëzore.

Ka qenë kjo arsyeja, që ne ndërmorëm programin “Mësues për Shqipërinë” dhe realizuam testimin në dhjetor, që ishte testim rankues i të gjithë punëkërkuessve, sipas profileve të tyre, për çdo qark të Shqipërisë. Sigurisht, ky rankim u konceptua edhe si një masë e rëndësishme në luftën kundër korrupsionit, sigurisht, për të hequr e për të pamundësuar Lizat apo këdo tjetër, të vjetër e të rinj, që e përdorin postin në arsim, që i përdorin emërimet e mësuesve në arsim për arsyet e tyre, por që nuk kanë të bëjnë me cilësinë e shkollës dhe me cilësinë e burimeve njerëzore.

Në momentin që ne flasim, është realizuar që postet e reja edhe vendet vakante që dolën pas evidentimit të mësuesve pa arsim përkatës, por edhe pas një mase të marrë nga Ministria e Arsimit, me uljen e normës së mësuesve, sigurisht për t’iu ardhur në ndihmë mësuesve dhe shkollave, për të funksionuar edhe me atë funksionin tjetër, që e nderuara zonja kryetare pyeti, që lidhet me cilësinë e edukimit, pra për të funksionuar si shkolla qendra komunitare, ne kemi mundësuar që, në masën më të madhe, ky fenomen i shfaqjes së mësuesve pa arsim përkatës apo jashtë profilit, të jetë minimizuar, por ende tani që flasim ka zona të thella, shkolla të caktuara, të cilat kanë kryesisht numër të vogël nxënësish, që në profile të caktuara ende vijojnë me mësues që janë pa arsimin përkatës, por masa e nxënësve që preket nga këta mësues është diku te 30 mijë. Pra, 140 mijë nxënës tashmë vijojnë mësimin me mësues brenda profilit apo që kanë arsimin e duhur.

Sigurisht, ne jemi duke evidentuar faktet dhe, besoj në vitin e ri akademik shkollor, do të mundësojmë edhe riadresimin e këtij procesi, përmes incentivave të ndryshme dhe mbështetjeje që mund tu japim mësuese të rinj, të cilët shprehin gatishmërinë për të shkuar e për të punuar në këto zona disi të largëta e të vështira. Ata do të mbështeten nga qeveria – edhe nga shoqëria besoj, po aq – në mënyrë që edhe këtë dukuri ta pamundësojmë edhe në shkolla të largëta të vendit, në të ashtuquajturat shkolla me klasa kolektive apo shkolla të bashkuara.

Për sa i përket fenomenit të korrupsionit, sigurisht që ju iu referuat një rasti, që në fakt tregon vullnetin e kësaj qeverie për të kthyer në vend kulturën e ndëshkueshmërisë dhe jo modën e kulturës së pandëshkueshmërisë, sigurisht të vendosur për ti çuar atje ku e kanë vendin të gjithë ata që shkelin ligjin, të gjithë ata që përkundrejt rryshfetit apo korrupsionit, abuzojnë me detyrën.

Është një luftë që nuk mbaron në një ditë. Është një luftë për të cilën nuk mjafton vetëm vullneti, por sigurisht duhet një set masash dhe sisteme të shëndetshme, që pamundësojnë korrupsionin. Një nga sistemet e shëndetshme, besoj se është edhe ky sistemi i ofruar për emërimet në arsim, që ka një komponent tejet të rëndësishëm, që është i e transparencës, ku të gjithë mësuesit, punëkërkuessit, rankohen sipas një testimi të unifikuar, të standardizuar në nivel kombëtar, në mënyrë që drejtuesit, prindërit, komunitetet ta kenë të qartë cilësinë, por edhe radhën e përcaktuar në bazë të cilësisë, në bazë të konkurrencës dhe transparencës, për punësimet në sistemin arsimor.

Sigurisht që folët për disa momente të vështira, që janë shfaqur në shkollën shqiptare, që lidhen me dhunën e me fenomene të tjera. Jemi të angazhuar dhe po e adresojmë secilën prej tyre në partneritet edhe me shumë organizma të tjerë, po aq edhe me partnerë të rëndësishëm, përmes punës me projektet, por sigurisht është një sfidë e madhe përpara nesh; jo vetëm përpara shoqërisë shqiptare, por besoj se është një sfidë e madhe që i tejkalon kufijtë e vendit tonë. Mendoj se projekti i funksionimit të shkollave si qendra komunitare, që e vendosin pikën e rëndësës jo thjesht e vetëm tek ora e mësimit, në lëndë apo në programe të caktuara mësimore, por në të gjithë atë që quhet jetë shkollore, duke e lidhur ngushtësisht mësimdhënien me cilësinë e edukimit dhe duke mundësuar rolin e komunitetit, të prindërve, të aktorëve të rëndësishëm të komunitetit në

të gjithë atë që përbën sot jetën shkollore, besoj se ne do të bëjmë hapa cilësore përpara edhe në parandalimin e fenomeneve të tilla që ju përmendët.

Në lidhje me tekstet, ne sigurisht propozojmë shkuarjen drejt teksteve unike, duke mos hequr dorë nga konkurrenca, duke u lënë mundësinë shtëpive botuese – jo 31 shtëpive botuese në 2 milionë banorë, që sot operojnë me ato shifra që unë paraqita pak më parë, por sigurisht shtëpive botuese me integritet, për të forcuar kapacitetet e tyre, për të marrë më të mirën nga gjithë ky proces tetëvjeçar, që u lidh me altertektstin. Ndërkohë, ju bëj me dije se në këtë vit të ri shkollor, në klasën e parë dhe në klasën e gjashtë, ku implementohen kurrikula e re e bazuar në kompetenca, ne do të operojmë me lëndët e shkencave, në partneritet me shtëpi botuese si Oksford, Kembrixh, Pirson, me të cilat kemi filluar bashkëpunimin – shtëpitë botuese i kanë kontraktuar – për të përkthyer dhe përshtatur edhe për nxënësit shqiptarë tekstet me të cilat operojnë nxënës të atyre shkollave.

Ju bëj me dije gjithashtu, që ky është një eksperiment i realizuar me sukses në Shqipëri, për shkak të faktit se sot në Shqipëri ka shkolla ku studiojnë fëmijë shqiptarë – nuk janë shkolla publike, janë shkolla private – që operojnë me linjën e plotë të këtyre teksteve që vijnë nga Kembrixh i apo Oksfordi. Sigurisht, tekstet e tjera do të botohen nga autorë shqiptarë.

Pyetja tjetër kishte të bënte me faktin e ku qëndron risia që ne propozojmë, nëse ne vijojmë që ende të jenë drejtorët e shkollës ata që zgjedhin mësuesit. Është shumë e vërtetë se ky proces shpeshherë ka degraduar, për shkak të faktit se ligji nuk i vesh me përgjegjësi, le ët themi, komisionet që ngrihen në bazë shkolle. Shpeshherë ka qenë e pamundur – kryesisht në shkolla të vogla, në shkolla që ndodhen në zona rurale – të ndërtoheshin komisionet e prindërve apo përfaqësuesve të pushtetit vendor. Shpeshherë, konfliktet e tyre personale apo, le të themi, fakti se ligji nuk i vesh me përgjegjësi, ka bërë që mbledhjet e këtyre komisioneve të dështojnë dhe procesi i përzgjedhjes së mësuesve të shkojë në zgrip, duke lënë gjurmë në procesin mësimor, sepse është një situatë shumë dinamike, e cila lidhet me cilësinë e orës së mësimi dhe nuk mund të presim që procedurat të zgjaten, ndërkohë që nxënësit apo shkolla është pa mësim.

Në fakt, ajo që ne propozojmë është riorganizimi i këtij procesi jo duke lënë jashtë prindërit, të cilët sigurisht janë pjesë e rëndësishme e procesit të përzgjedhjes së



mësuesve, por ngritja e komisioneve të jetë mbi bazën e drejtorive apo zyrave arsimore të komisioneve të prindit, të ketë një proces tejet të qartë dhe transparent, që lidhet me rankimin, me testimin rankues të mësuesve. Vendet vakante për çdo shkollë dhe për çdo pozicion të jenë transparente për të gjitha komunitetet e shkollës.

Pra, nuk hiqet dorë nga roli i drejtorit, nuk hiqet dorë nga roli i komisionit të prindërve, por sigurisht duke e përmirësuar edhe me disa tregues të tjerë, që rrisin transparencën dhe përgjegjësinë e këtyre komisioneve.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Momenti tjetër, që lidhet me digjitalizimin. Kompetenca dixhitale është një ndër kompetencat e gjithë kornizës kurrikulare europiane. Sigurisht që fëmijët tanë janë përpara, por gjithçka është në mënyrë autodidakte. E rëndësishme është që ne ne ta sjellim në këtë formim edhe shkollën shqiptare. Procesi i dixhitalizimit, në momentin që flasim, është duke avancuar në 60 gjimnaze të Shqipërisë, për të mundësuar në këto 60 gjimnaze që kanë një shtrirje në të gjithë Shqipërinë, edhe në qytetet e mëdha, edhe në zona më të vogla, për krijimin e dy klasave në secilën nga këto shkolla, që do të kenë mundësi që në lëndë të caktuara të ofrohet mësimdhënia dhe mësimnxënia dixhitale, përmes kontentit digjital dhe përmes përdorimit të teknologjisë.

Sigurisht, kjo është një sfidë e madhe. Edhe në vendet e tjera, ku është ndjekur kjo metodologji, ka pasur probleme. Shqipëria ka shansin dhe mundësinë që ta kapërcejë hendekun dixhital, duke përfitur nga eksperiencat më të mira dhe, sigurisht, duke punuar fort në trajnimin e mësuesve në momentet që po flasim, kompani prestigjioze po realizojnë trajnimin e mësuesve, sepse është shumë e vërtetë që nxënësit janë një hap para mësuesve dhe ndoshta, ky është momenti më i vështirë që duhet adresuar me shumë profesionalizëm, në mënyrë që efienca të jetë e plotë.

**Majlinda Bregu** – I jap fjalën zotit Imami.

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Po, keni dhe pjesën për *bullying-un* në shkolla, por le të bëjë fillimisht zoti Imami një pyetje.

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

**Arben Imami** – Faleminderit!

Zonja Ministre,

Me këto rregullime më duket se trajtoni dy çështje që janë shumë të rëndësishme: tekstin dhe mësuesit.

Pra, mënyrën e përzgjedhjes së teksteve dhe të mësuesve. Mbas këtyre janë dhe 3-4 elemente të tjera të rëndësishme për shkollën, që ajo të shkojë në ato drejtime që ju përcaktoni.

Duke pasur rezerva në lidhje me faktin nëse alterteksti funksionoi, apo jo, sipas opinionit tuaj, duke rënë dakord që doni ta ndryshoni altertekstin dhe do të dilni me një tekst të vetëm unik, edhe unë, personalisht, do të isha për një zgjidhje më të ndërmjetme.

Pra, të biem dakord me parimin e tregut, por të biem dakord me parimin e tregut, i cili funksionon në mënyrë ligjore dhe institucionale, prej të cilit del produkti më i mirë, pra, rritja e konkurrencës dhe jo shkatërrimi i konkurrencës dhe i produktit.

Padyshim, këto vite ka pasur produkte të mira.

Padyshim, këto vite ka pasur edhe probleme.

Të na falni, se ne nuk jemi anëtarë të Komisionit për Arsimin, por jemi të gjithë prindër dhe kemi interes për çështjen e arsimit dhe jemi më të informuar për të, sesa për çështjet e tjera.

Për arsimin, për politikën dhe për futbollin janë të gjithë të gatshëm të diskutojnë, në të gjithë botën.

Megjithëse komisioni ka tjetër qëllim, na lejoni të flasim diçka për këtë.

Në parim, nëse e heqim parimin e tregut, i cili bën seleksionimin dhe përzgjedhjen nëpërmjet konkurrueshmërisë, unë nuk shoh në këtë nen që ju po propozoni, mënyrën e rregullimit të seleksionimit dhe garancinë që përzgjedhja për një tekst të vetëm dhe unik (për shembull, Historia e klasës së shtatë në të gjitha shkollat e Shqipërisë, do të jetë ky tekst dhe jo ai tekst). Faktikisht, po vijmë te një tekst i vetëm, i cili, gjithashtu, kishte problemet e veta.

Ju thoni këtu që procedura e zhvillimit të konkursit përcaktohet me udhëzim të ministrit. Domethënë gjënë më të rëndësishme, tekstin, i cili unifikon sistemin arsimor (mësuesit janë persona me dallimet dhe veçoritë e tyre), por teksti, i cili unifikon sistemin arsimor, zgjidhet me një procedurë konkursi me udhëzim të ministrit. Themeli i sistemit tonë arsimor parauniversitar do të merret me një vendim të ministrit.

Kjo nuk ka asnjë garanci as te personi juaj, as te ndonjë person tjetër. Edhe sikur të kishim garanci për ju, ju vetë, nuk mund të jepnit garanci për atë që do të vijë pas jush.

Për mua ky është një problem serioz që kërkon një trajtim së pari, në ligj të paktën, sipas parimeve. Procedurat e konkurrimeve i kemi të rregulluara me ligj në këtë vend. Ndoshta, disa elemente, mund t'i lireshin KM-së apo ministrit përkatës.

Po këtë problem kam, edhe për mënyrën e përzgjedhjes së mësuesve.

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Për mendimin tim, i njëjti problem mbetet edhe për mënyrën e konkurrimit dhe të vlerësimit, që përcaktohet me udhëzim të ministrit. Përzgjedhja e mësuesve është po aq e rëndësishme. Jam plotësisht dakord që të decentralizohet.

Jam plotësisht dakord që komuniteti i prindërve të ketë një votë.

Nuk jam kundër këtyre ideve, por sa më shumë të decentralizohet një proces, sa më poshtë të shkojë një proces aq më pak të mundur do ta kemi, të ketë njerëz që mbajnë përgjegjësi, pra, të ketë llogaridhënie. Kjo do të kërkonte, për mendimin tim, disa rregulla më të mira, të vendosura në një nivel më të lartë, sesa udhëzimi i ministrit.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** - Duke filluar nga çështja e fundit, personalisht, jam shumë dakord me këtë që thoni për arsimtarët. Do të ishte shumë më mirë sikur ne të operonim me portalin, ku rankohen të gjithë mësuesit dhe çdo vend i lirë shkon sipas renditjes. Besoj se e gjithë kundërshtia që vjen, edhe posaçërisht nga opozita, procesi ka të bëjë me faktin që kjo dispozitë të lihet te shkolla, te prindërit.

Unë ju falënderoj dhe ndaj të njëjtën qasje. Duke parë situatën në vend, duke i dhënë përparësi një komponenti shumë të fortë, që ka të bëjë me transparencën, duke mundësuar testimin rankues të të gjithë punëkërkuessve, sipas profileve, duke e bërë transparent për çdo qark, për çdo drejtori dhe çdo zyrë arsimore, sigurisht, do të mundësojmë atë që kërkojmë: të shkojnë drejt shkollës mësuesit më cilësorë, duke respektuar meritën dhe konkurueshmërinë.

Është bërë një hap i tillë drejt decentralizimit që sigurisht, ka efektet e veta pozitive, sepse i bën prindërit, drejtuesit, trupën pedagogjike më të përgjegjshme.

Ky ndryshim i propozuar, në ligjin ekzistues është shkolla, janë prindërit dhe drejtori i shkollës.

Ne propozojmë këtë ndryshim për ta ngritur në një nivel pak më të lartë, qoftë edhe në nivel qarku, duke i dhënë edhe këtë komponent të rëndësishëm, që lidhet me ranikimin.

Çfarë ka ndodhur? Ata 4 mijë mësues, nëse nuk do të kemi një qasje dhe një transparencë të plotë, do të shtohen e do të shtohen vazhdimisht, sepse as shkolla as komuniteti i prindërve nuk kanë një informacion të profesionalizuar, të standardizuar, që lidhet me cilësinë e mësuesve. Kjo është ajo që po bëjmë.

Sa i përket momentit tjetër, që lidhet me propozimin e ministrit për realizimit të procesit përzgjedhës, kështu është edhe në nenin aktual.

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Keni të drejtë. Ajo që shtohet është fakti që kemi vendosur standardet. Deri sot përzgjedhja bëhej mbi disa kritere që përcaktoheshin nga ministri, ndërsa tashmë, kemi propozuar një dokument shumë të rëndësishëm, që është dokumenti i standardeve të teksteve shkollore, i cili është një mekanizëm i rëndësishëm që orienton komisionin drejt zgjedhjes së teksteve më cilësore.

Mekanizmi i dytë përmirësues, që nuk ka ekzistuar në këto 8 vjet, ai i përzgjedhjes së altermekstet, ka të bëjë me procesin e pilotimit.

Nuk do të ketë tekste edhe kur rankohen si cilësore, të certifikuara nga komisioni dhe që futen në katalog, pa kaluar edhe sfidën e pilotimit, pra, një periudhë 1 ose 2 vjeçare që pilotohen në shkolla dhe atëherë, do të certifikohen si tekste shkollore.

Faleminderit!

**Majlinda Bregu** – Zonja Ministre,

Shoh që edhe deputetët kanë lëvizur dhe nuk vazhdojmë dot mbledhjen, nëse nuk rikthehen për të bërë kuorumin.

Nuk dua të zgjatem më megjithëse, pak më parë harrova t'ju pyes për pjesën e maturës shtetërore për të cilën keni vendosur të mos jetë më përcaktuese për pranimin në universitete, gjë që është pjesë e propozimeve të këtij projektligji.

E dyta, ju sugjeroj t'i riktheheni një deklaratë të partisë suaj të majtë, të vitit 2013 për të konfirmuar se sa mirë e keni ditur numrin e mësuesve problematikë atëherë, në Shqipëri.

E treta, nuk mora përgjigje për fenomenin *bullying* në shkolla. Kam përshtypjen se nëse deputetët nuk kanë gjëra të tjera për të diskutuar, duhet të vijojmë me votimin. Ndërkohë, gjëja më e rëndësishme për këtë komision, përtej prezantimit tuaj të hollësishëm dhe ju përgëzoj për të gjitha njohuritë që keni marrë ndërkohë, për arsimin në Shqipëri, është edhe mendimi i Drejtorisë së Legjislacionit në Kuvend.

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Prisni, sa të mbaroj fjalinë!

Nuk e kam për ju, personalisht.

Mendimi i Drejtorisë së Legjislacionit në Kuvend është shumë i rëndësishëm për ne. Nuk ka përputhje apo mospërputhje me *acquis communautaire*, sepse ky është një legjislacion që rregullohet për çdo vend, por është pjesë e Planit Kombëtar të Integritit Europian dhe MSA-së. Kjo do të thotë se me ndryshimet me të cilat Komisioni për Arsimin dhe Mediet ua ka kërkuar t'i paraqisni në projektligj, si komision përgjegjës, bashkohemi edhe ne.

Sigurisht, duke i qëndruar edhe mendimit të Drejtorisë së Legjislacionit në Kuvend, e cila thotë se nuk ka probleme përputhshmërie me *acquis communautaire* dhe është në linjë me Planin Kombëtar të Integritit Europian.

Atëherë, ta hedhim në votim, sepse pyetja për maturën shtetërore nuk ka të bëjë me këtë projektligj.

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Jo, për pranimin në universitete.

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Prandaj thashë, se nuk ka të bëjë me këtë projektligj.

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Zonja Ministre,

Thashë: njohuritë tuaja, për të gjithë bashkë dhe jo njohuritë tuaja personale. Të gjitha njohuritë tuaja, si maxhorancë për arsimin, dhe jo tuajat personale.

Kjo maxhorancë që kishte këto probleme, që i ngritëm të gjithë bashkë, të mësuesve e të të tjerëve. Pak më parë ju thashë, se nuk është përgjegjësia juaj personale, por për fat të keq qëlluan në kohën e qeverisjes suaj. Për këtë e kisha diskutimin.

Unë ju thashë të prisnit sa të mbaroja fjalinë. Këto probleme ju s'mund t'i mohoni se ju vetë ishit në dijeni të problematikave që kanë ndodhur gjatë kësaj kohe.

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Shumë problematika. Ishte drejtoreshë e arsimit zonja atje, në Lushnjë, që bënte gjëmën, të cilën nuk e kishim emëruar ne, por e kishit emëruar ju, me këto procedura konkurrimi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Jo, as e afrojmë fare. As të na lajë dhe as e shpëlajmë dot ne.

Ajo le të merret me drejtësinë. Të lahet dhe të shpëlahet edhe për akuza të tjera.

Atëherë, jeni dakord me projektligjin, me propozimet e Komisionit për Arsimin dhe Mediet? Dakord. Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Ju falënderojmë, edhe ju!

**Kryetare**  
**Majlinda Bregu**

**Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve**  
**Euzheni Pengili**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**  
*Komisioni për Integrimin Europian*

Dokument parlamentar

**PROCESVERBAL**

Datë 12.05.2015, ora 11:30

**Drejton mbledhjen:**

**Majlinda Bregu – kryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për investimin nga llogaria EU/IPA e bypass-it Vlorë, për bypass-in e Vlorës”.

2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, si Administrator i Fondeve Grant, të siguruara nga qeveri të vendeve të ndryshme nën fondin e veçantë të aksionarëve të BERZH-it, për bypass-et rrugore të Fierit dhe Vlorës, asistencë teknike për mbështetjen e zbatimit të projektit në Shqipëri”

**Marrin pjesë:**

Majlinda Bregu, Esmeralda Shkja, Arben Imami, Taulant Balla, Bujar Derveni, Kejdi Mehmetaj, Sadri Abazi dhe Gerti Bogdani.

**Mungojnë:**

Edi Paloka, Ilir Xhakolli dhe Gramoz Ruçi.

**Të ftuar:**

Elda Sotiri – përfaqësuese nga Ministria e Integritit Europian.

Ylli Manjani – zëvendësministër i Transporteve dhe Infrastrukturës.

Mimoza Loli - përfaqësuese nga Ministria e Financave.

Elona Mishovica – përfaqësuese nga Ministria e Financave.



**Majlinda Bregu** – Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës. Janë dy marrëveshje. Njëra është marrëveshja e grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për investimin nga llogaria EU/IPA e bypass-it Vlorë, për bypass-in e Vlorës.

Me IPA-n e re dhe me ndarjen e re ka ndryshime, pra duhet që qeveria të çojë strategjitë që ka dhe më pas të marrim grantet.

Është edhe marrëveshja e grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, si Administrator i Fondeve Grant, të siguruara nga qeveri të vendeve të ndryshme nën fondin e veçantë të aksionarëve të BERZH-it, për bypass-et rrugore të Fierit dhe Vlorës, për asistencë teknike për mbështetjen e zbatimit të projektit në Shqipëri”.

Do të donim një prezantim të shkurtër, nëse keni ndonjë gjë përtej atyre që janë në relacion.

**Ylli Manjani** – Fare shkurt, sa i takon marrëveshjes së IPA-s. Ky është komponenti i tretë i financimit të bypass-it të Vlorës. Ju e dini që BERZH-i dhe BEI kanë dhënë respektivisht kredi nga 18 milionë euro. Kësaj kredie prej 36 milionë eurosh, po i shtojmë dhe 8 milionëshin e IPA-s për të zbutur kredinë.

Dy kreditë e para janë marrë. Tani është komponenti i tretë që është kalimi i fondeve të IPA-s në financimin e këtij projekti. Këtu ka një diskutim që është bërë edhe në komisionet e tjera. Çështja është që na është bërë kjo pyetje dhe po ua jap paraprakisht përgjigjen, pa m’u bërë pyetja në këtë komision.

Pyetjes se përse vijnë në Kuvend, i përgjigjem se është gjykuar kështu, sepse është një VKM, që është marrë prej kohësh dhe kjo mund të ishte e mjaftueshme. Megjithatë, është gjykuar që për shkak të praktikave të mira parlamentare, të certifikohet edhe një herë kushtetutshmëria e çdo ratifikimi, sipas nenit 21 të Kushtetutës. Nga kjo pikëpamje, kjo marrëveshje nuk ka asnjë problem me nenin 121 dhe nuk cenon as territorin, as paqen dhe as elemente të tjerë për të cilat flet neni 121 i Kushtetutës.

Kjo sa i përket marrëveshjes së parë.

Sa i takon marrëveshjes tjetër, bëhet fjalë për një grant prej 250 mijë euro që qeveritë e vendeve të BERZH-it i kanë akorduar Shqipërisë, në funksion të monitorimit dhe të mbikëqyrjes së projekteve të bypass-it të Vlorës dhe të Fierit. Ajo që ka ndodhur është, se në marrëveshjen që ne kemi me BERZH-in, në nenin 9, është vënë si kusht që Autoriteti Rrugor Shqiptar të ketë ekspertë në terren, të cilët do të ndjekin kalendarin e punimeve, pa qenë e nevojshme të shprehet për çdo rast Autoriteti Rrugor Shqiptar. Ideja është të çojmë Autoritetin Rrugor Shqiptar në terren. Ky është një detyrim që vjen nga ajo marrëveshje dhe kushti ishte që ose të harxhonim për këtë 250 mijë euro nga buxheti i shtetit ose të negocionim për t'i marrë grant dhe ne zgjodhëm opsionin e dytë, për të siguruar financimin e këtij shërbimi.

Edhe kjo është një marrëveshje pa ndonjë problem, në kuptimin e nenit 121 të Kushtetutës.

Nga kjo pikëpamje, janë paraqitur këto dy marrëveshje në parlament për ratifikim.

**Majlinda Bregu – Faleminderit!**

Kam përshtypjen se kjo është marrëveshja e tretë në formë granti që ne po kalojmë për asistencën rrugore, brenda 1 muaji. Janë të gjitha fondet e destinuar vetëm për të nxjerrë Autoritetin Rrugor Shqiptar në terren për të bërë kontrollin?

Domethënë, 250 mijë euro janë destinuar për arritjen e një performance më të lartë në menaxhimin e projekteve rrugore.

Kemi kaluar edhe 2 marrëveshje të tjera si kjo, para 1 muaji.

A keni më projekte për asistencë teknike, të cilat janë pjesë e granteve për këtë periudhë, sepse dua të jem e qartë?

**Ylli Manjani** – Nuk di të them se nuk kam ndonjë inventar në këtë moment, por sa më shumë grante të kemi, aq më mirë është.

**Majlinda Bregu** – Më mirë do të ishte për ndonjë punë tjetër, sesa për asistencë teknike.

**Ylli Manjani** – Kjo është praktikë e BERZH-it. Edhe në raste të tjera të ngjashme ku ka hyrë BERZH-i, gjithmonë e kanë këtë praktikë. Ata duan të kenë konsulencën në terren.

Është tjetër gjë shuma 150 mijë euro. Ideja është që për të shkurtuar të gjithë procesin vendimmarrës administrativ dhe për të pasur 1 sy dhe një vesh në terren ARRSH-ja, BERZH-i gjithmonë e ka praktikuar këtë.

Kjo asistencë është shumë më konkrete sesa ajo asistencë teknike, që është kritikuar kur ka qenë fjala për kritika, për hir të së vërtetës.

**Majlinda Bregu** – Faleminderit!

Kush ka pyetje apo komente?

Atëherë, jeni dakord me projektligjin e parë? Dakord.

Taulanti është gjithmonë dakord, pa u hedhur në votim, me nismat e kësaj qeverie.

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Taulanti thotë se është e certifikuar.

Kolegët e tjerë, janë dakord me këtë marrëveshje? Kundër? S'ka. Abstenim?  
S'ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Atëherë, kush është dakord me marrëveshjen e dytë? Kundër? S'ka. Abstenim?  
S'ka.

Miratohet.

Faleminderit!

## **MBYLLET MBLEDHJA**